



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

---

**PROGRAMI I BURSAVE PËR GJUHËN MODERNE GREKE  
DHE KULTURËN GREKE PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017**

Fondacioni Shtetëror Grek i Bursave ofron 50 **bursa studimi të gjuhës moderne greke dhe kulturës greke** për shtetasit e huaj nga të gjithë vendet e botës për vitin akademik 2017-2018.

Formularët e aplikimit dhe i gjithë informacioni i nevojshëm për këto bursa, ku përfshihet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësojnë kandidatët, masa e bursës, kushtet e përfitimit, etj. gjenden në linkun [www.iky.gr](http://www.iky.gr)

Kushtet e pranimit:

1. kandidatët duhet të kenë shtetësi të huaj përjashtuar atë greke (jo me dyshtetësi),
2. të kenë mbaruar studimet bachelor në një universitet jo grek jashtë Greqisë,
3. të mos kenë qenë më shumë se 40 vjeç në 1.1.2017,
4. të mos kenë banim të përhershëm në Greqi,
5. njohuritë dhe dijet e marra gjatë kursit të gjuhës greke duhet të përmirësojnë mundësitë për punësim të kandidatëve dhe të promovojnë gjuhën dhe kulturën greke në botë.

Kurset do të fillojnë në tetor 2017 dhe mbarojnë në maj 2018.

Dokumentet që duhen dorëzuar:

1. formulari i aplikimit, i nënshkruar dhe me fotografi,
2. jetëshkrim i përditësuar në gjuhën angleze ose greke,
3. kopje të noterizuara të diplomave universitare,
4. kopje të noterizuara të gjuhës greke (nëse ka) ose të gjuhëve angleze ose frënge,
5. dy letra rekomandimi nga profesorë universiteti (në greqisht, anglisht ose frëngjisht),
6. vërtetim me shkrim që është i/e punësuar si mësues i gjuhës greke, nëse e ka,
7. një certifikatë mjekësore e lëshuar nga një spital kombëtar rreth 1 muaj para aplikimit,
8. kopje e pasaportës së vlefshme/kartës së identitetit (sipas rastit).

Afati i fundit për aplikimin elektronik nëpërmjet adresës së emailit [foreigners@iky.gr](mailto:foreigners@iky.gr) është **6 shtator 2017**. Dokumentacioni i plotë në letër duhet të përcillet nëpërmjet ambasadës ose konsullatës së përgjithshme të Republikës Helene në Korçë dhe Gjirokastrë brenda datës **11.9.2017**.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE**